



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-2601/14
Dep. 02	Br. Prot. 11-07-2014
Nr. i faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2002/14, për znj. Fitore Rexhaj – Ish Anëtare e Kuvendit Komunal të Istogut, për arsye se e njëjta, tashmë, ka mbaruar mandatin e Anëtares së Kuvendit Komunal dhe ndërkohë nuk ushtron asnjë funksion tjetër publik, prandaj nuk ka konflikt interesi.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2002/14, për znj. Fitore Rexhaj – Ish Anëtare e Kuvendit Komunal të Istogut, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.SH. “ENGINEERING I.B.”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ish zyrtares së lartë znj. Rexhaj, së pari i është bërë një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës ajo është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë, me ç’rast është kuptuar se tashmë nuk është zyrtare e lartë për shkak se i ka mbaruar funksioni i saj publik si Anëtare e Kuvendit Komunal të Istogut dhe nuk ka marrë ndonjë funksion tjetër si zyrtare e lartë.

Këtë e kemi konfirmuar me formularin për deklarimin e pasurisë, të cilin znj. Rexhaj e ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsionit.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

